



AKTIVITETI VJETOR 2024

KËSHILLI BASHKIAK KUKËS

RAPORTI I PERFORMANCËS SË KËSHILLIT BASHKIAK KUKËS 2024

Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues, mbikëqyrës dhe vendimmarrës i vetëqeverisjes vendore, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës, ligjshmërisë, duke përdorur me ekonomi dhe efektivitet burimet njerëzore,financiare, fizike e natyrore si dhe teknologjike të bashkisë.

Veprimtaria e Këshillit Bashkiak mbështetet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligjet, aktet nënligjore në zbatim të tyre si dhe rregulloret e miratuara nga vet këshilli, si më poshtë:

1. Ligji ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
2. Ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”.
3. Ligji nr. 8480 date 27.5.1999, “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike.
4. Ligji nr. 115 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive te qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
5. Ligji nr.107 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”.
6. Ligji nr. 119 datë 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit”.
7. Ligji nr. 146 datë 30.10.2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.
8. Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.
9. Ligjinr. 9367 datë07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave”,i ndryshuar.
10. Ligji nr. 9131 datë08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”
11. Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.22 datë 25.02.2020 “Për miratimin e rregullores së Organizimit dhe të Funksionimit të Këshillit Bashkiak Kukës”.
12. Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.119, datë 22.05.2020“Për miratimin e rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në bashki”.
13. Vendimin e Këshillit Bashkiak për marrëdhëniet e këshillit me publikun e mediat.
14. Vendimi Nr. 118, datë 22.05.2020 “ Për miratimin e rregullores për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare”.
15. Vendimin e Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kodit etik dhe parandalimit të konfliktit të interesave për këshilltarin bashkiak”.

REALIZIMI I FUNKSIONIT VENDIMMARRËS

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak përcaktohen në nenin 54 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore si dhe ligje të tjera.

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;
- c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak;
- ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
- dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
- e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;
- f) vendos për taksat e tarifatat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
- g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
- gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
- h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t’i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;
- j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji;

k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë

atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;

l) vendos për simbolet e bashkisë;

ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;

m) jep tituj nderi dhe stimuj;

n) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim të bashkia.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2024, Këshilli Bashkiak Kukës ka realizuar **11** mbledhje radhe dhe vetëm 1 mbledhje jashtë radhe. Në këtko mbledhje janë marrë gjithsej **93** vendime.

Janar 2024

Mbledhja është zhvilluar me datë 26.01.2024, sipas njoftimit të datës 19.01.2024 <https://www.facebook.com/photo/?fbid=673829911581925&set=pcb.673819408249642>, ku u morën 11 vendime, si: miratimi i kritereve dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit 6%, dhënie pagese për rastin e daljes së punonjësve në pension pleqërie, ndryshim buxheti, miratim i raportit për vlerësimet afatmesme të të ardhurave, , miratimi i numrit të anëtarëve të kryesisë së fshatrave në të gjitha njësitet administrative, miratimi i grafikut të zgjedhjeve të strukturave komunitare, ngritja e komisionit të integritetit europian, akordim ndihme financiare për një familje të dëmtuar nga zjarri, dhënie titulli “Qytetar Nderi”.

Mbledhja u transmetua live <https://www.facebook.com/100068647660124/videos/746327803749933>,

Shkurt 2024

Mbledhja është zhvilluar me datë 23.02.2024, sipas njoftimit të datës 16.02.2024 <https://www.facebook.com/photo/?fbid=689797813318468&set=pcb.689797989985117>, ku u morën 7 vendime: dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, dhënie pëlqimi për dhënie me qira të pasurisë Nr. 2208 për fotovoltaike dhe pasurisë prej 0.061 ha dhe 1.65 km rrugë për vendosje antenash celulare, miratim i planit për parandalimin dhe shuarjen e zjarrit, miratim shpërblimi për

nxënësit që fituan medalje të artë, shtim në listën e prioriteteve të projektit për kanalizimet e ujërave të zeza në fshatin Bardhoc.

Me datë 16.02.2024, sipas njoftimit <https://www.facebook.com/photo/?fbid=679454921019424&set=pcb.679455034352746>, këshilli bashkiak Kukës realizoi seancë konsultimi publik lidhur me projektvendimin “Për dhënie pëlqimi në parim për dhënie me qira të pasurisë Nr. 2208, të llojit pyll (shkurre), pjesë të saj, konkretisht sipërfaqen prej 15 ha, pjesë e pasurisë në fshatin Kolsh, Njësia Administrative Kolsh, Bashkia Kukës. Fusha e përdorimit të pronës që jepet me qira të jetë: “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse)”



Foto nga seanca e konsultimit publik me banorët e njësisë administrative Kolsh

Mbledhja u transmetua live <https://www.facebook.com/100068647660124/videos/1475136996719705>,

Mars 2024

Mbledhja është zhvilluar me datë 03.04.2024, sipas njoftimit <https://www.facebook.com/photo/?fbid=707358438229072&set=pcb.707358781562371>, ku u morën 7 vendime: dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, miratim I raportit të konsoliduar të monitorimit të buxhetit të vitit 2023, miratimi i tavaneve përgatitore të shpenzimeve, miratim i marrëveshjes ReLOaD2, dhënie mandate për një anëtar të këshillit, miratim raporti për mbarimin e mandatit para afatit për një anëtar të KB. Gjatë këtij muaji janë zhvilluar 3 mbledhje komisionesh. Gjatë muajit mars Këshilli Bashkiak ka mbikëqyrur procesin e zgjedhjes së strukturave në disa fshatra të njësive administrative sipas grafikut.

Mbledhja u transmetua live <https://www.facebook.com/100068647660124/videos/3699015563669190>,

Prill 2024

Mbledhja është zhvilluar me datë 26.04.2024, sipas njoftimit të datës 19.04.2024, ku u morën 7 vendime: dhënie mandate për një anëtar të këshillit bashkiak, miratim I dhënies së ndihmës ekonomike, akordim fondi për blerje për drejtorinë e emergjencave civile, ndryshim në buxhetin e bashkisë Kukës, miratimin e programit të transparencës për Bashkinë Kukës, miratimin e studimit të fizibilitetit për një segment të tunelit nëntokësor.

Gjatë muajit prill Këshilli Bashkiak ka mbikëqyrur procesin e zgjedhjes së strukturave në disa fshatra të njësive administrative sipas grafikut.

Mbledhja u transmetua live <https://www.facebook.com/100068647660124/videos/7512581455503169>,

Maj 2024

Mbledhja u zhvillua me datë 04.06.2024, sipas njoftimit të datës 19.05.2024 <https://www.facebook.com/photo/?fbid=746245251007057&set=pcb.746245327673716>, ku u morën këto vendime: dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, miratim i dhënies në përdorim pa afat të pasurisë nr 25/48-N5ZK 23/5 me sipërfaqe 161 m2, Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës., miratim fondi për dhënie pagese për rastin e daljes në pension pleqërie, shtim në listën e prioriteteve i projektit për rikonstruksionin e shkollës Bajram Curri dhe kthimi i saj në shkollë profesionale, shpërblimi i sportistave të nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre që kanë arritur

rezultate në veprimtaritë kombëtare, miratimi i raportit të komisionit të mandateve për zgjedhjet e strukturave komunitare.

Mbledhja u transmetua live
<https://www.facebook.com/100068647660124/videos/1480064859261054>.

Qershor 2024

Mbledhja u zhvillua me datë 05.07.2024, sipas njoftimit të datës 26.06.2024, <https://www.facebook.com/photo/?fbid=764836415814607&set=pcb.764836565814592>, ku u morën 13 vendime: miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, miratim i grafikut për zgjedhjet e strukturave komunitare në disa fshatra të njësive administrative, dhënie pëlqimi në parim për dhënie me qira të pasurisë 155/1 të llojit pyll, në fshatin Drinas, për qëllime pushimi, argëtimi, kënde lojërash, Dhënie në përdorim të një sip. 0.5 ha, nga fondi pyjor/kullosor, për objektin Hec Malla (shtesë) në funksion të aktivitetit të shoqërisë “Gjurr Reç”, miratim i rinovimit të kontratës së qirasë për fondin pyjor/kullosor 0.04 ha dhe 0.8 km rrugë, për vendosjen e antenave të kompanive celulare, miratimi i raportit periodik 4 mujor, miratim I planit të përmirësimit të arsimit parashkollor, miratim i kërkesës për transferim në pronësi të bashkisë Kukës të pasurive për t’i përdorur për shërbime funerale”, miratim i shpërblimit të nxënësve që fituan vendin e parë në kampionatin e shkollave, akordim ndihme për familje të dëmtuar nga zjarri.

Në këtë mbledhje, këshilli bashkiak **rrëzoi projektvendimin** “Për miratimin me shkrim për vijimin e procedurave për ndryshimin e kategorisë së përdorimit të fondit pyjor 0.677 ha, për subjektin Pepa Group. Arsyet e rrëzimit të këtij projektvendimi lidhen me pretendimet e pronesisë që kanë disa banorë të kësaj zone.

Përpara këtyre vendimmarrjeve, Këshilli Bashkiak realizoi 3 seanca konsultimi publik, Në Drinas, Fusharë dhe Arrën. Rekomandimet e dhëna nga banorët gjatë këtyre seancave, u morën parasysht dhe u pasqyruan në vendimet përkatëse.



Foto nga seanca e konsultimit me banorët e Njësisë Administrative Surroj



Foto nga seanca e konsultimit me banorët e Njësisë Administrative Kolsh, Drinas



Foto nga seanca e konsultimit me banorët e Njesisë Administrative Arrën

Mbledhja e muajit qershor u transmetua live
<https://www.facebook.com/100068647660124/videos/386335621127987>.

Korrik 2024

Me datë 19.07.2024, Këshilli Bashkiak, me kërkesë të 1/3 të anëtarëve, zhvilloi mbledhje jashtë radhe <https://www.facebook.com/photo/?fbid=775013404796908&set=a.398156845815901>, për të trajtuar problemin e hyrjeve dhe daljeve në qytetin e Kukësit, pas përfundimit të punimeve për urën e re. Në këtë mbledhje, Këshilli Bashkiak në mënyrë unanime vendosi mosndërprerje aksesit të hyrjeve dhe daljeve në qytetin e Kukësit përmes rrugës ekzistuese.

Gjithashtu, miratoi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6%.

Linku I transmetimit live:
<https://www.facebook.com/100068647660124/videos/1264569744527946>.

Gusht 2024

Mbledhja e radhës e muajit gusht u zhvillua me datë 30.08.2024, sipas njoftimit <https://www.facebook.com/photo/?fbid=798051322493116&set=pcb.798051545826427> ku u morën 4 vendime: dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, miratim fondi për dhënie pagese

për rastin e daljes në pension pleqërie, deklarin e mbarimit të mandatit para afatit për një anëtar të këshillit. Video e transmetimit të mbledhjes gjendet ne linkun <https://www.facebook.com/100068647660124/videos/877927017582992>

Shtator 2024

Mbledhja e radhës e muajit shtator 2024, u zhvillua me datë 01.10.2024, sipas njoftimit <https://www.facebook.com/photo/?fbid=818481580450090&set=pcb.818481740450074> ku u morën 9 vendime:

Miratim i dhënies së ndihmës ekonomike nga fndi 6%, akordim fondi për blerje makine për drejtorinë e emergjencave, miratim i draft dokumentit të parë të PBA 2025-2027, miratimi i tavaneve përfundimtare të shpenzimeve, shtim në listën e prioriteteve i sistemim asfaltim i rrugëve Nangë dhe Krenzë, miratim i një ndryshimi në buxhetin e bashkisë, miratimi i raportit të dytë periodik 8 mujor,

Video e transmetimit të mbledhjes: <https://www.facebook.com/100068647660124/videos/1428194971902665>
<https://www.facebook.com/100068647660124/videos/509637985194906>

Tetor 2024

Mbledhja e radhës e muajit tetor 2024 u zhvillua me datë 8.11.2024, sipas njoftimit <https://www.facebook.com/photo/?fbid=839902134974701&set=pcb.839902298308018> ku u morën 5 vendime: miratimi i dhënies së ndihmës ekonomike, miratimi i mandatit të një anëtar të këshillit, akordim ndihme për një familje banesa e të cilëve është djegur nga zjarri, miratim i marrëveshjes për projektin Culture for Future, rinovim i pallatit të kulturës.

Transmetimin e mbledhjes e gjeni ne linkun: <https://www.facebook.com/100068647660124/videos/1124408235974589>
<https://www.facebook.com/100068647660124/videos/1638723670089042>

Bashkia Kukës realizoi seancën e konsultimit me publikun lidhur me PBA 2025-2027 si dhe buxhetin e vitit 2025. <https://www.facebook.com/photo/?fbid=402556679593391&set=pcb.402557956259930>



Foto nga konsultimi publik per PBA 2025-2027

Nëntor 2024

Mbledhja e radhë e muajit nëntor 2024 u zhvillua me datë 02.12.2024, sipas njoftimit <https://www.facebook.com/photo/?fbid=858691133095801&set=pcb.858691303095784> , ku u morën 8 vendime: dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, miratimi i nivelit të pagave të punonjësve për vitin 2024, miratimi i shpërblimit të sportistëve të nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre, shpërbm për punonjësit që kanë dalë në pension pleqërie, financim i pagesës së qirasë për një automjet të përdorur për grumbullimin e mbeturinave, zgjedhjen e anëtarit përfaqësues në këshillin e qarkut, për ngritjen e komisionit të përkohshëm për mbikëqyrjen e investimeve publike.

Mbledhja u transmetua live <https://www.facebook.com/100068647660124/videos/908507784707874>

Dhjetor 2024

Mbledhja e radhës për muajin dhjetor 2024 u zhvillua me datë 27.12.2024, sipas njoftimit <https://www.facebook.com/photo?fbid=876185731346341&set=pcb.876185854679662> ku u morën 13 vendime; dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, shpërnarja e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar, miratimi i taksave dhe tarifave për vitin 2025, miratimi i lanit të aktiviteteve dhe konsultimeve të këshillit bashkiak, miratimi i tavaneve përfundimtare të shpenzimeve, miratimin e PBA 2025-2027, miratimi i buxhetit të vitit 2025, miratimi i planit të përshtatjes për ndryshimet klimatike 2024-2040, miratimi i grafikut të zgjedhjeve për një anëtar të

kryesisë së fshatit Mustafaj. Mbledhja u transmetua live <https://www.facebook.com/100068647660124/videos/1280877999619676>.

Mbledhjet frekuentohen nga shumica e këshilltarëve. Ka një numër këshilltarësh që nuk marrin pjesë rregullisht në mbledhjen e këshillit dhe komisioneve duke penguar zhvillimin e mbledhjeve ku në disa raste mbledhjet janë shtyrë për këtë arsye. Edhe vonesat në fillimin e mbledhjeve mbeten një problem që duhet zgjidhur në vazhdimësi.

I gjithë dokumentacioni i projekt-vendimeve të shqyrtuara gjatë mbledhjeve të Këshillit është publikuar në faqen eeb të këshillit për tu dhënë mundësi qytetarëve të njihen me to. Në regjistrin online për transparencën e mbledhjeve të këshillit janë dokumentuara të gjitha informacionet mbi mbledhjet duke filluar nga thirrja e mbledhjes, oraret e mbajtjes, videot e mbledhjes dhe proces verbalet tyre. Mbledhjet e Këshillit janë transmetuar online në facebook të Këshillit Bashkiak dhe në mediat lokale, të mundësuar nga bashkëpunimi me projektin Bashki të Forta (financuar nga Qeveria Zvicerane). Kjo i jep Këshillit Bashkiak një pavarësi në transmetimin pandërprerje livestream të mbledhjeve dhe i krijon mundësi të jetë transparent në lidhje me të gjitha vendimet që merr dhe problemet që trajton për ti ardhur në ndihmë qytetarëve.

Gjatë vitit 2024 janë zhvilluar mbledhjet e komisioneve të përhershme me pjesëmarrjen e këshilltarëve. Numrin më të madh të mbledhjeve e ka komisioni i përhershëm i Ekonomisë Financave Pasurive Bashkiake Mbikëqyrjes Financiare Planifikimit dhe Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, e më pas Komisioni i Kulturës Arsimit e Sportit, Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile Infrastrukturës Strehimit dhe Sherbimeve Publike.

Roli mbikëqyrës

Përveç ushtrimit të rolit vendimmarrës, Këshilli Bashkiak ka ushtruar dhe funksionin mbikëqyrës, duke kërkuar edhe informacione apo raporte nga administrata. Të tilla mund të përmendim:

- 1.Raport nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për masat e marra për nisjen e procesit mësimor dhe gjendjen e institucioneve arsimore publike
- 2.Raport nga Drejtoria e Ujësjetë- Kanalizimeve lidhur me situatën e furnizimit me ujë gjatë sezonit të verës.

3.Raport nga Drejtoria e Rrugëve lidhur me gjendjen e infrastrukturës në qytet si dhe njësitë administrative gjatë periudhës së dimrit.

Gjithashtu, anëtarë të këshillit bashkiak kanë drejtuar kërkesa për informacion lidhur me probleme të veçanta.

Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve

Në total në Këshillin Bashkisë Kukës për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë regjistruar 38 kërkesa/ankesa të cilat janë trajtuar në mbledhjen e komisionit përkatës, ndërsa pjesa tjetër është trajtuar drejtpërdrejt nga Sekretari i Këshillit në bashkëpunim me drejtoritë. Pjesa më e madhe kërkesave ka qënë për emërtime rrugësh dhe kërkesa për informacion. Të gjitha kërkesat dhe ankesat janë të publikuara në regjistrin online të kërkesave-ankesave në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak.

Konsultimi me publikun

Përfshirja e qytetarëve në procesin vendimmarrës është një prej elementëve përcaktues për një qeverisje të mirë. Ky detyrim buron nga ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Këshilli i ka kushtuar vemendje të veçantë dëgjësive publike për projektaktet për të cilat kërkohet nga ligji. Janë zhvilluar dëgjesa publike për disa projektakte: Dhënie pronash në përdorim, taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Kukës, projektbuxhetin afatmesëm 2025-2027 si dhe seanca konsultimi publik lidhur me buxhetin e vitit 2025. Në dëgjesa morën pjesë qytetarë, përfaqësues biznesesh, grupe interesi, anëtarë këshilli, të cilët kanë dhënë rekomandimet e tyre.

Të gjitha informacionet për konsultimet e publikun janë të publikuara në regjistrin online për konsultimet me publikun në faqen e këshillit bashkiak.

Lidhur me konsultimet publike për vitin 2024, sekretariati i këshillit bashkiak ka hartuar një raport të vecantë i cili është publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Kukës.

Transparenca e aktiviteteve të këshillit, kryesisht njoftimet për konsultimet publike, publikimi i procesverbaleve dhe elemente të tjera të seancave të konsultimit me komunitetin, janë bërë objekt studimi i shoqatave të pavarura sic është Qendra për Progres Rinor. Raporti studimor i realizuar nga QPR me gjetjet dhe vlerësimet përkatëse është publik.

Marrëdhëniet me Prefektin e Qarkut

Këshilli Bashkiak Kukës, në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ka dërguar pranë institucionit të prefektit për verifikim ligjshmërie të gjitha aktet me karakter normativ.

Asnjë akt nuk është kthyer për rishqyrtim.

Gjithashtu, përfaqësues të institucionit të prefektit kanë kryer kontrollin e verifikimit të ligjshmërisë në vend, sipas parashikimeve ligjore.

Marrëdhëniet me administratën e bashkisë

Sekretariati i Këshillit Bashkiak ka bashkëpunuar dhe koordinuar punën me administratën e bashisë lidhur me projektaktet e paraqitura për miratim.

Konstatohen problematika në lidhje me paraqitjen e projektvendimeve brenda afateve ligjore, mungesa të disa përfaqësuesve të drejtorive në mbledhjet e komisioneve apo mbledhjet e këshillit. Kërkohet një bashkëpunim më i madh në këtë aspekt.

Aktivitetet kryesore të Këshillit

Gjate vitit 2024 Këshilli bashkiak, sipas planit vjetor të veprimtarive, ka realizuar mbledhjet e parashikuara dhe ato jashtë radhe, mbledhjet e komisioneve, seancat e komunikimit me publikun si dhe aktivitetet e tjera si trajnime të këshilltarëve, komisioneve, kryesisë së Këshillit, etj.

Ndër aktivitetet kryesore të vitit 2024:

1. Ndjekja e procesit të zgjedhjeve të strukturave komunitare. Këshilli Bashkiak ka përcaktuar me vendim grafikun për zgjedhjet e strukturave komunitare në të gjitha njësitë administrative. Procesit është ndjekur nga përfaqësues të këshillit në çdo njësi. Zgjedhjet kanë përfunduar në shumicën e fshatrave dhe janë përsëritur në disa fshatra ku ka pasur ankesa për procesin.

Në fshatrat ku zgjedhjet nuk janë zhvilluar për shkak të mospjesëmarrjes së banorëve, kryetarët e fshatrave janë emëruar nga Kryetari i Bashkisë.

2. Open Day, takim me qytetarët i realizuar në tetor të 2024 me mbështetjen e Bashkisë së Fortës, nëpërmjet të cilit synojmë të informojmë qytetarët për aktivitetet tona dhe të marrim rekomandimet e tyre në funksion të përmirësimit të veprimtarisë.

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=832886242342957&set=a.398156845815901>

<https://www.facebook.com/100068647660124/videos/1211174316805383>

3. Vizitë studimore e këshillit bashkiak Memaliaj në bashkinë Kukës. Shkëmbim eksperiencash mes 2 këshillave bashkiake me fokus kryesor aspektet e transparencës dhe garantimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=875078154790432&set=pcb.875078394790408>

4. Trajnime të anëtarëve të komisioneve. Përgjatë vitit 2024, anëtarët e komisioneve kanë vijuar trajnimet, aktivitete kësto te mbështetura nga Bashkia e Fortë dhe AMVV.

Komisionet kryesore të trajnuara gjatë 2024 janë: Komisioni i Ekonomisë dhe Komisioni i Shërbimeve Publike.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eridona Ramallari

KUKËS 21.02.2025